



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr.157/2022

Datë: 20 prill 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e jashtëzakonshme të 284-të, të mbajtur me 20 prill 2022, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Bashkohet procedura-kërkesa për inicim të procedurës disiplinore për lëndët disiplinore AD-GJTHM/09/2022 dhe AD-GJTHM/10/2022.
- II. Anëtarë për të shërbyer në panelin hetimor për lëndët Nr.AD/ KGJK/11/2022/ GJTHM-AD-GJTHM/09/2022 dhe AD-GJTHM/10/2022, caktohen gjyqtarët:
  - Saranda Bogaj Sheremeti, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kryesuese;
  - Hakile Ilazi, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj, anëtare;
  - Ilmi Bajrami, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, anëtar;
  - Luljeta Maxhuni, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, anëtare rezervë;
  - Fejzullah Rexhepi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës, anëtar rezervë;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 20 prill 2022.

**A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 20 prill 2022, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, sipas nenit 11 dhe 12 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve, që janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që do të hetohet.

Paneli hetimor zhvillon hetimin bazuar në nenin 12, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethanat të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit, Këshilli mundë t'i zgjasë mandatin panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.

- Kopje e vendimit i dërgohet:
- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Arkivit.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

